Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Majlinda Bedrolli ***Ekspert shqyrtues***	***Data e autorizimit të ekspertit*** ***11.05.2022***	***Data e dorëzimit të raportit*** ***18.05.2022***	***Nr. i lëndës:*** ***135/22***

1.BAZA LIGJORE E SHQYRTIMIT

Me datën: 10.05.2022, OE ankues **"Mazreku" shpk- Malisheve**, ka parashtruar ankesë me nr: **135/22,** kundër propozimit për dhënie të kontratës, ku është rekomanduar për operatori ekonomik **"Etiani" - Istog ,** lidhur me aktivitetin e prokurimit: ***"Furnizim me material për rrethoj te Oksigjenit",*** me nr.të prokurimit**:** 70020-22-3041-1-3-6, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK)- Spitali i Përgjithshem-Gjakovë.

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë të hapur, procedura e kuotimit të çmimit-funizim, kriteri i dhënjes së kontratës çmimin më i ulët, lloji i procedurës Kuotim i çmimit, çmimi më i ulët vlera e parashikuar e kontratës: 2 000,00 €

Data e njoftimit për kontratë 11/04/2022, Afati i fundit i dorëzimit të tenderit 19.04.2022, Njoftimi i vendimit të AK-së, 22.04.2022, kërkesa për rishqyrtim 24.04.2022,Vendimi nga ana e AK-se per kërkesën për rishqyrtim 04.05.2022.

Konform nenit 113, 114 të Ligjit Nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068 dhe Ligjin 05/L-092, Eksperti Shqyrtues i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues.

2. PRETENDIMET ANKIMORE

OE ankus pretendon se AK, nuk i ka respektuar dispozitat e LPP-së, siç janë:

Neni 1, 6, 7, 59, dhe 65 të LPP-së.

DEKLARATA DETALE E ANKESES

Autoriteti kontraktues Spitali i Përgjithshem-Gjakovë, me datë 22.04.2022, ka publikuar vendimin e AK për këtë procedurë duke propozuar për kontratë OE Etiani. Ky OE ka çmimin më të lartë se oferta jonë dhe ne kemi shikuar Letrën standarde për Tenderuesin e eliminuar të cilën AK na ka dërguar ne e ku ka cekur arsyen e eliminimit te tenderit tonë në këtë procedurë.

Arsyeja pse AK na ka eliminuar ne është:

"Tenderi juaj është refuzuar për këto arsye: "Deklaratën nën betim është nënshkruar nga persona të pa autorizuar"!!!

Në të gjitha procedurat e prokurimit Deklaratën nën betim nënshkruar nga Bashkim Mazreku sepse për këtë ekziston autorizimi i datës 23.10.2019, i noterit ku ceket se Afrim Mazreku e autorizon Bashkim Mazreku për nënshkrimin e të gjitha dokumenteve përfshirë kontratat dhe përfaqësimin e biznesit "Mazreku" shpk në të gjitha institucionet.

Ky autorizimi është para datës së dorëzimit të ofertave dhe nëse AK ka të pa kjartë këtë situatë konform nenit 72 të LPP-së, ka munduar të kërkojë sqarime siç specifikohet ne LPP dhe Rroupp, e jo të dëmtoje buxhetin siç ka vepruar me vendimin e datës 22.04.2022.

Me këtë veprim AK ka vepruar në kundërshtim me nenin 59 të LPP-së, nenin 72 të LPP-së, dhe nuk ka respektuar dispozitat tjera ligjore lidhur më këtë procedurë siç janë nenet:

Neni 1 Qëllimi

Neni 6 Ekonomiciteti dhe Efikasitetit

Nenin 7 Barazi në Trajtim / Jo-Diskriminim

Neni 59 Ekzaminim Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderave

Neni 65 Pranushmëria e Kandidatëve ose Tenderueseve

Kërkojmë nga OSHP që lëndën ta kthejë në Rivlerësim të detyrohet AK që ta rivlerësoj ofertën tonë duke marr parasysh faktin që ekziston Autorizimi për të cilin AK na ka eliminuar dhe të na shpallë ne fitues si OE i

përgjegjshëm me çmimi më të lirë. Dëmtimi i buxhetit të AK qoftë për 30.5 euro është në kundërshtim me LPP-në dhe është vepër e dënuar për të cilën ne si OE do të ndjekim të gjitha hapat ligjor nëse OSHP dhe AK nuk ndërmarrin masa për ti evituar shkeljet që ka bërë AK në vendimin e datës 22.04.2022. Siç e kemi dërguar edhe në AK po e bashkëngjisim Autorizimin e datës 23.10.2019, me të cilin kontestohet se me këtë autorizim deklaratën nën betim është nënshkruar nga Bashkim Mazreku si person i autorizuar e jo siç e ka cekuar AK në vendimin e datës 22.04.2022, *"Deklaratën nën betim është nënshkruar nga persona të pa autorizuar"*.

3. FAKTET E RASTIT TË RËNDËSISHME PËR PRETENDIMET

III.2.1) Kërkesat e përshtatshmërisë: **Operatori ekonomik duhet ti përmbush kërkesat mbi përshtatshmërinë në pajtim me Ligjin Nr.04 L-042.për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04 L-237, ligjin Nr. 05 L-068 dhe ligjin Nr. 05 L 092 .Neni 65.**	*Dëshmia e kërkuar dokumentare:* **Në deklaratë e shkruar nën Betim, e nënshkruar nga tenderuesi duke përdorur formën e përcaktuar në dosijen e tenderit Aneks 2.**
Në dokument nga Administra Tatimore e vendit tuaj të themelimit,se ju nuk jeni me vonesë për pagimin e tatimeve së paku deri në tremujorin e fundit para datës së publikimit të Njoftimit të Kontratës.	**Vërtetim nga Administrata Tatimore (kopje).duhet të dorëzohen vetëm nga tenderuesi fitues,para publikimit të dhënies së kontratës.**
Një dokument i lëshuar nga Gjykata kompetente që vërteton se operatori ekonomik i përmbush Kërkesat e përshtatshmeris të jetë i lëshuar së paku deri në tremujorin e fundit para datës se publikimit të Njoftimit të Kontratës.	**Vërtetim nga Gjykata Themelore Departamenti për Qështje Ekonomike (kërkohet origjinal ose i vërtetuar noterizuar nga institucioni kompetent në vendin tuaj të themelimit).duhet të dorëzohen vetëm nga tenderuesi fitues,para publikimit të dhënies së kontratës.**
III.2.2) Përshtatshmëria profesionale: **Regjistri i operator ekonomik në regjistrin profesional,komercial dhe apo regjistrin e ndërmarrjeve në vendin e juaj te themelimit (ARBK).**	*Dëshmia e kërkuar dokumentare:* **Certfikata e ARBK-se.(kopje).**

4. RAPORTI I KOMISIONIT VLERËSUES

Duke u bazuar në B58 Njoftimin mbi vendimin e autoritetit kontraktues të datës 22.04.2022, është konstatuar si në vijim: AK- Spitali i Përgjithshem-Gjakovë, shpërblen me kontratë operatorin ekonomik "Etiani" - Istog**,** më çmimin e ofruar prej 1.774,00 euro.

5. VENDIMET E MËPARSHME LIDHUR ME RASTET E NGJASHME

N/A

6. ARSYETIMI PËR DEVIJIM NGA PRAKTIKA E MËPARSHME

NA

7. VLERËSIMI I PRETENDIMEVE TË NDRYSHME TË ANKESËS

Sqarim hyrës: Autoriteti kontraktues Spitali i Përgjithshëm-Gjakovë, gjatë këtij aktiviteti të prokurimit ka zbatuar ka zbatuar procedurë të hapur, procedura e kuotimit të çmimit-funizim, kriteri i dhënjes së kontratës çmimin më i ulët, lloji i procedurës Kuotim i çmimit, çmimi më i ulët. Pretendimi kryesor ka të bëjë kundër arsyetimit te eliminimit të parashtruesit të ankesës ku AK – Spitali i Përgjithshëm-Gjakovë, përmes letrës standarde për tenderuesin e eliminuar të datës 22.04.2022, shprehimisht ka potencuar: Tenderi juaj është refuzuar për këto arsye: ***"Deklaratën nën betim është nënshkruar nga persona të pa autorizuar"***

Kundër të njëjti arsyetim parashtruesi i ankesës **në afatin e paraparë ligjor ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim** tek Autoriteti kontraktues me pretendimet e njëjta ankimore si në ankesën e parashtruar në OSHP përderisa AK- Spitali i Përgjithshëm-Gjakovë, përmes vendimit refuzon kërkesën si të pa bazuar me arsyetimin se kërkesa për rishqyrtim nuk ishte e plot dhe në përputhje me rregullat për paraqitje të kërkesës për rishqyrtim pran Autoritetit kontraktues parashtrimit të ankesave pranë OSHP dhe vlerën e tarifave te ankesave përkatësisht nenit 5 sepse kërkesa për rishqyrtim nuk kishe asnjë dokument te bashkangjitur te cilat duhet te kishte sipas kësaj rregullore. AK përmes sistemit të E-prokurimit me datë 27.04.2022 i ka dërguar kërkesë Operatorit ekonomik sipas nenit 6 të kësaj rregullore me të cilin ka kërkuar plotësimin e kërkesës për rishqyrtim. Mirëpo Operatorit ekonomik nuk e ka bere një gjë te tillë brenda afatit kohore prej dy ditësh te përcaktuar me dispozita e kësaj rregullore prandaj edhe refuzohet kërkesa për rishqyrtim si e paplotë.

Sqarojmë se ne bazë të platformës se e-prokurimit rezulton se OE ankues "Mazreku" shpk- Malisheve ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim tek Autoriteti kontraktues në afatin e paraparë ligjor ku kjo kërkesë për

rishqyrtim përmban elementet e nenit 5 të Rregullat për paraqitje te kërkesës për rishqyrtim pranë Autoriteteve Kontraktuese F03, me përjashtim të pikës *d) bashkëngjitur një kopje të njoftimit të kontratës në fjalë ose njoftimit të rezultatit të konkursit për projektim, nëse një e tillë është nxjerrë apo publikuar;* i cili nuk e ka bashkangjitur kopjet dokumentin të njoftimit të kontratës në kërkesën për rishqyrtim megjithatë sqarojmë se tani te gjitha njoftimet qe lidhen me një aktivitet te prokurimit janë të ngritura në platformën e prokurimit dhe për me tepër kërkesa për rishqyrtim është parashtruar tek i njëjti autoritet kontraktues.

Përgjigje në pretendimet ankimore (Neni 113 LPP) "Mazreku" shpk- Malisheve

Pas administrimit dhe shqyrtimit të shkresave te lendes kundrejt pretendimeve ankimore, operatori ekonomik ankues "Mazreku" shpk- Malisheve, potencon se për Deklaratën nën betim të nënshkruar nga Bashkim Mazreku ekziston autorizimi i noterizuar me datë 23.10.2019, ku ceket se Afrim Mazreku e autorizon Bashkim Mazreku për nënshkrimin e të gjitha dokumenteve përfshirë kontratat dhe përfaqësimin e biznesit "Mazreku" shpk në të gjitha institucionet. Me tej OE ankues shton se autorizimi është para datës së dorëzimit të ofertave dhe nëse AK ka pas të pa qartë këtë situatë konform nenit 72 të LPP-së, ka munduar të kërkojë sqarime siç specifikohet ne LPP dhe Rroupp, e jo të dëmtoje buxhetin siç ka vepruar me vendimin e datës 22.04.2022.

Sqarojmë se AK tek III.2.1) Kërkesat e përshtatshmërisë ka kërkuar:
Kërkesat e përshtatshmërisë: *Operatori ekonomik duhet ti përmbush kërkesat mbi përshtatshmërinë në pajtim me Ligjin Nr.04 L-042.për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04 L-237, ligjin Nr. 05 L-068 dhe ligjin Nr. 05 L 092 .Neni 65.*
Dëshmia e kërkuar dokumentare:
Në deklaratë e shkruar nën Betim, e nënshkruar nga tenderuesi duke përdorur formën e përcaktuar në dosjen e tenderit Aneks 2.
Sqarojmë se në ofertën e parashtruesit të ankesës, rezulton qe i njëjti në ofertë ka të bashkangjitur deklaratën nën betim, siç është përcaktuar në dosjen e tenderit Aneks 2, me të dhëna si emri i OE, adresa e plotë, emri dhe pozita, nënshkrimi, data, dhe vulosur në emër të operatorit ekonomik.

Megjithatë në kërkesën për rishqyrtim dhe në ankesën e parashtruar në OSHP nga OE ankues "Mazreku" shpk, është bashkangjitur kopja e aktit noterial nga noteri me numër Nr.LRP.6797/2019, ku "Mazreku" shpk-

Malisheve të cilën e përfaqëson pronari z.Afrim Mazreku me dt.. më .. dhe numër te letërnjoftimit .. e autorizoj z.Bashkim Mazreku me të dhëna si në aktin noterial qe në rast të mungesës të përfaqëson "Mazreku" shpk-Malisheve, ne Ministritë e Republikës se Kosovës Administratën Tatimore Gjykata, Zyrat Noteriale, Administratat Komunale, Zyrat Doganore, lidhur me aplikimin nxjerrjen, vërtetimin, paraqitjen e kërkesave të ndryshme **dhe nënshkrimin e dokumenteve te nevojshme të "Mazreku" shpk- Malisheve** etj..... eksperti shqyrtues sqaron se në bazë të kësaj shkrese kopje të aktit noterial e cilat është bashkangjitur nga operatorit ekonomik ankues "Mazreku" shpk në kërkesën për rishqyrtim dhe ne ankesën e parashtruar në OSHP me numër Nr.LRP.6797/2019, rezulton se ky autorizim është para datës së njoftimit për kontratë dhe para afatit për dorëzimin e tenderëve. Megjithatë AK konform dispozitave ligjore të LPP-së, gjatë procesit të ri vlerësimit mundet të kërkoj informata shtese verifikoj këtë akt noterial se a është i autorizuar z.Bashkim Mazreku, të përfaqëson ne emër të biznesit "Mazreku" shpk.

Përfundimisht, ne mbështetje te asaj qe u përshkrua si me larte, rekomandimi ynë për AK - Spitali i Përgjithshem-Gjakovë, është që lenden ta kthej në ri vlerësim me qellim qe të pasqyrohet gjendja reale e ofertave kundrejt kërkesave të vendosura në dosje te tenderit, konform dispozitave të LPP-së në tersi dhe në veçanti nenit 72.

Provë: bashkangjitur me raport gjeni kopje e Autorizimit nga noterit Nr.LRP.6797/2019, te OE ankues "Mazreku" shpk- Malisheve dhe Deklaratën nën betim.

Republika e Kosovës
N o t e r
Minir Zekolli
Suharekë

Nr.LRP.6797 /2019

Unë Noteri Minir Zekolli, me seli në Suharekë, rruga "Hajdin Berisha" p.n. vërtetoj se sot, me datë 23.10.2019 (Njëzet e tre Tetor dymijë e nentetëmbëdhjetë), në Zyrën time të Noterisë u paraqit dhe nga unë kërkoi që të përpiloj këtë akt noterial:----------

---

"Mazreku"SH.P.K,me numër unik identifikues 811303784 me adresë në Guriq Komuna e Malishevës, të cilën e përfaqëson Pronari **Afrim Mazreku,** i lindur me 27.06.1982 në Guriq,me vendbanim në Guriq Komuna e Malishevës, Shtetas i Kosovës, posedon numrin personal 1000811013, identifikohet përmes letërnjoftimit nr. ID006880537, i vlefshëm deri më 22.01.2027, lëshuar nga MPB e Republikës së Kosovës.----------

---

Pasi e vërtetova faktin se pjesëmarrësi në këtë akt noterial është i aftë dhe i autorizuar të ndërmerr këtë veprim, ia spjegova qëllimin dhe pasojat nga ky akt noterial, e vërtetova qëllimin e tij dhe se ky veprim nuk është në kundërshtim me ligjet në fuqi, në bazë të deklarimeve të personit të pranishëm, si dhe në bazë të nenit 36, 37 dhe 38 të Ligjit për Noterinë kam hartuar këtë----------

----------**A U T O R I Z I M**----------

E autorizoj Z.Bashkim Mazreku, i lindur me 07.07.1986 në Guriq Komuna e Malishevës, me vendbanim në Guriq Komuna e Malishevës, Shtetas i Kosovës, posedon numrin personal 1171342526 dhe letërnjoftimin nr.ID0446354 lëshuar nga MPB e R së Kosovës:----------

Që në rast të mungesës time të përfaqëson "Mazreku"SH.P.K në Ministritë e Republikës së Kosovës, Administratën Tatimore, Gjykatat, Zyrat Noteriale, Administratat Komunale,Zyrat Doganore, lidhur me aplikimim, nxjerrjen, vërtetimin, paraqitjen e kërkesave të ndryshme dhe nënshkrimin e dokumenteve të nevojshme të "Mazreku"SH.P.K, si dhe të ketë të drejtë që në emër të "Mazreku"SH.P.K të nënshkruan kontratat e shitblerjes për të gjitha automjetet dhe makinat, si dhe të kryen të gjitha shërbimet e nevojshme lidhur me regjistrimin dhe qregjistrimin e automjeteve në pronësi të "Mazreku"SH.P.K, në Qendrat e Regjistrimit të Automjeteve.--------

I Autorizuari ka të drejtë të nënshkruan kontrata për bashkëpunime Afariste, si dhe të ketë të drejtë të nënshkruan faturat e ndryshme në emër të ""Mazreku"SH.P.K.----------

Ky autorizim vlen deri në revokimin e të njëjtit nga Autorizuesi.----------

Pjesëmarrësit në këtë akt noterial personalisht ia kam lexuar përmbajtjen e këtij akti dhe përmes pyetjeve të parashtruara, kam konstatuar se përmbajtja e këtij akti noterial është shprehje e vullnetit të tij të vërtetë, andaj në shenjë aprovimi ai e vuri nënshkrimin e tij.----------

Për përpilimin e këtij akti noterial është paguar kompensim në shumë prej 10,00 Euro si tarifë noteriale, si dhe 18%TVSH, gjithësejt 11,80 Euro (njëmbëdhjetë euro e tetëdhjetë Cent), konform nenit 21, paragrafi 8 të U. A.nr. 02/2012 për Tarifat e Përkohshme Noteriale.----------

Në Suharekë, më 23.10.2019 (Njëzet e tre Tetor dymijë e nentëmbëdhjetë).----------

AUTORIZUESI:
Për: "Mazreku"SH.P.K
Pronari: Afrim Mazreku

MAZREKU SH.P.K.

AFRIM MAZREKU

N O T E R I:
Minir Zekolli

Aneksi 2. DEKLARATA NËN BETIM

Unë, i poshtë nënshkruari, duke përfaqësuar: [***MAZREKU SHPK***] deklaroj nën betim se jam i përshtatshëm në përputhje me Nenin 65, të Ligjit mbi Prokurimin Publik në Kosovë, Ligji Nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092.

Unë vërtetoj se i kam lexuar kërkesat e përshtatshmërisë në Nenin 65 të LPP-së, respektivisht seksionin III.1 të Informacionit për Tenderuesit, dhe vërtetoj se i përmbush kërkesat e përshtatshmërisë për pjesëmarrje ne këtë procedure te prokurimit.

Unë pranoj mundësinë e sanksionimeve penale dhe civile, gjobave dhe dënimeve, nëse unë për shkak të pakujdesisë dorëzoj çfarëdo dokumenti ose deklarata që përmban informata përmbajtësish të gabueshme ose mashtruese.

Identifikimi i Operatorit Ekonomik (OE)	
Emri i OE:	**MAZREKU SHPK**
Adresa e plotë:	**GURIQ MALISHEV**
Përfaqësuar nga:	
Emri	**BASHKIM MAZREKU**
Pozita	**MENAGJER**
Nënshkrimi	
Data	**13.04.2022**
Vula	MAZREKU SHPK

8. MENDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si e bazuar, të anulohet njoftimi për dhënie të kontratës, si dhe lënda të kthehet në **rivlerësim**.

Raporti i eksperizës ti dorëzohet:

Autoritetit Kontraktues - Spitali i Përgjithshem-Gjakovë.

- Panelit Shqyrtues - OSHP.
- OE ankues - “Mazreku” shpk- Malisheve